

Performanca e Buxhetit 2018



NË KËTË RAPORT

Periudha raportimit: Janar - Dhjetor 2018

Statusi raportit: Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Mirditë gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Mirditë me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion kontaktoni Znj. Flora Fufti në adresën e mail: fufi.flora@yahoo.com

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 22.103 banorë
 Rregjistri Civil 37.384 banorë
 Sipërfaqja: 869.71 km²
 Dendësia: Censuri (2011) 24.64 banorë/km²
 Rregjistri Civil 42.98 banorë/km²

Nëndarjet Administrative: 7

(1) Rrësheni (2) Rubiku (3) Selitë (4) Kthellë (5)
 Fan (6) Orosh (7) Kaçinar

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



EKZEKUTIVI Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Mirditë për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 28.158 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 54.57%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike LSI, PS, PD, PDIU dhe AAK. Kryetari i Bashkisë Mirditë është **Z. Ndrec DEDAJ**.

Departamentet e Bashkisë janë: ekonomi dhe financë; buxheti, tatim taksa vendore, politikat e zhvillimit, shërbimet publike, bujqësia dhe pyjet, shërbimet sociale, planifikim dhe kontrolli i teritorrit, policia bashkiake, mbrojtja e teritorit, ligjore, administrate dhe burimet njerëzore, arsim dhe edukim.

EKONOMIA Bashkia e re e Mirditës shtrihet në një territor me trashëgimi të larmishme kulturore dhe etnografike, ndërkohë që nëntoka e saj është gjithashtu e pasur me minerale. Mirdita është një zonë kryesisht bujqësore dhe blegtorale, ndërkohë që vreshtaria paraqet veprimtarinë prodhuese më kompetitive, me një treg të sigurt dhe mjaft atraktiv. Një nga fushat më interesante është edhe shfrytëzimi i kapaciteteve hidro – energjetike të lumenjve të Fanit të madh dhe Fanit të vogël, Urakës, Zallit të Dodajve, dhe përrrenjve të tjerë malorë. Sipërfaqja e pyjeve në bashkinë e Mirditës është 10 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore.

SITUATA FINANCIARE


- ⇒ Rritja e financimit të shërbimeve publike nga burimet e brendshme të bashkisë prej të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore pa rritur barrën fiskale.
- ⇒ Të ardhurat e veta të bashkisë zënë një peshë edhe më të madhe në burimet e bashkisë duke e rritur kontributin e tyre në tërësinë e fondeve buxhetore të bashkisë.
- ⇒ Përmirësim i menaxhimit buxhetor dhe qëndrueshmëri financiare duke kryer shpenzime buxhetore brenda burimeve të të ardhurave të mbledhura
- ⇒ Menaxhim i kujdesshëm i fondeve të bashkisë duke kryer shpenzime 100% në nivelin e të burimeve financiare.

Fakt 2016, 2017, 2018



Bazimi i informacionit:
"VFT 2018 - Ministria e Financave"

2018 Vs 2017



Bazimi i informacionit:
"VFT 2018 - Ministria e Financave"

BUXHETI 2018

Burimet e financimit (Buxheti i rishikuar) 2018

- ⇒ Transferta e pakushtëzuar
- ⇒ Transferta e kushtëzuar,
 - ⇒ Transferta specifike
- ⇒ Të ardhurat nga taksat dhe tarifrat
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017

Buxheti për vitin 2018 = 917.769 mijë lekë




Shërbimet kryesore të ofruara nga bashkia për vitin 2018


- | | |
|---|---|
| ⇒ Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | ⇒ ujitjes dhe kullimit |
| ⇒ Arsimi Bazë (përfshirë parashkollorin) | ⇒ Menaxhimi i Transportit Rrugor |
| ⇒ Arsimi i mesëm (profesional) | ⇒ Ujësjetës Kanalizime Vendore |
| ⇒ Shërbime të tjera ekonomike | ⇒ Shërbimet Publike Vendore |
| ⇒ Shërbimet Publike Vendore | ⇒ Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit |
| ⇒ Arsimi i mesëm (i përgjithshëm) | ⇒ Shërbime të Përgjithshme Publike V |
| ⇒ Administrimi i Pyjeve | ⇒ Mbështetje e zhvillimit ekonomik |
| ⇒ Arti dhe Kultura | ⇒ Përkujdesi Social |
| ⇒ Zhvillimi i Sportit | ⇒ Shërbimet Publike |
| ⇒ Emergjencat | |
| ⇒ | |
| ⇒ Infrastruktura e | |

Buxheti i realizuar për vitin 2018 = 879.724 mijë lekë

TË ARDHURAT 2018



Burimi: FPT 2019-2021, Bashkia Mirditë



Burimi: FPT 2019-2021, Bashkia Mirditë


SHPENZIMET

Bashkia Mirditë i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë shërbimeve sociale dhe infrastrukturës.


Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbënin rreth 70% të buxhetit, ashtu sikurse parashikohej janë:

- A. Përkujdesi Social
- B. Arsimi Bazë dhe Parashkolor
- C. Administrimi
- D. Shërbimet Publike

pesha në buxhet



Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore në Lekë




SHPENZIMET

Të ndara sipas aktivitetit ekonomik, shpenzimet kapitale përbëjnë 38% të totalit të shpenzimeve kurse ato operative 62%.


Në grafik paraqitet % e realizimit ndaj planifikimit, ndërsa tabela më poshtë liston investimet më të rëndësishme të bashkisë.

Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik në Lekë



Burimi i informacionit:
*Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia e Mirditës

Projektet e Investimeve në Lekë



Burimi i informacionit:
*Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia e Mirditës

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë, tregues performance sipas programeve.

PROGRAMI

MENAXHIMI MBETJEVE BASHKIAKE

Objektivi i programit


Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane

TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP1.** % e popullatës e mbuluar me shërbim
- ◆ **TP 2.** % e sipërfaqes së territorit e mbuluar me shërbim
- ◆ **TP 3.** % koston së shërbimit e mbuluar nga tarifa



tregues performance 2018



Kosto mesatare e menaxhimit të një ton mbetje bashkiake është rreth 5,500 Lekë

PROGRAMI

MENAXHIMI SISTEMIT TE VADITJES DHE KULLIMIT



Objektivi
Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të vaditjes dhe


Bashkia ka përmirësuar situatën për familjet fermere dhe biznesin bujqësor duke përmirësuar infrastrukturën e vaditjes dhe kullimit

TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP 1. Përmirësimi i shërbimit**
 - Rritja e sipërfaqes bujqësore e mbuluar me ujitje (trendi në %)
 - Rritja e sipërfaqes bujqësore së mbuluar me kullim (trendi në %)
- ◆ **TP 2. Përmirësimi i sistemit**
 - Përmirësimi i rrjetit të kullimit të pastruar apo shtuar (në % kundrejt rrjetit total)
 - Përmirësimi i rrjetit vaditjes të pastruar apo shtuar (% kundrejt rrjetit total)

Realizimi i shpenzimeve : rreth 95% e planifikimit, 41.682 mijë lekë, 4.7% e buxhetit

Ujitja dhe Kullimi



PROGRAMI

SHËRBIMI I UJIT TË PIJSHËM DHE KANALIZIMET

Objektivi i programit


Përminësimi i ofrimit të shërbimit të ujit të pijshëm

Përminësimi i menaxhimit të ujërave të përdorura (të zeza dhe të bardha) / shërbimeve sanitare

Realizimi i shpenzimeve : 100% e planifikimit, 48.272 mijë lekë dhe përbën rreth 5% të buxhetit




Performanca e shërbimit ujë i pijshëm dhe kanalizime 2016-2018



TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP 1.** Popullata e mbuluar me ujë të pijshëm (%)
- ◆ **TP 2.** Popullata e mbuluar me kanalizime sanitare (%)
- ◆ **TP 3.** Norma e mbulimit të kostos së shërbimit të ujit të pijshëm e mbuluar nga tarifa
- ◆ **TP 4.** Norma e mbulimit të kostos së shërbimit të kanalizimeve e mbuluar nga tarifa
- ◆ **TP 5.** Kohëzgjatja e u furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)

Kohëzgjatja e u furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)




PROGRAMI

ARSIMI BAZË DHE PARASHKOLLOR

Objektivi i programit

Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet e arsimit parashkollor

Realizimi i shpenzimeve : rreth 100% e planifikimit, 154.838 mijë lekë, 18% e buxhetit



TREGUES PERFORMANCE

- ♦ **TP 1.** Rritja e efijencës së fondeve buxhetore (në % kundrejt planit)
- ♦ **TP 2.** Përmirësimi i ngrohjes së godinave të arsimit parashkollor (në % kundrejt planit)
- ♦ **TP 3.** Ofrimi i një ushqimi cilësor (në % kundrejt planit)

Arsimi baze dhe parashkollor



PROGRAMI

PËRKUJDESI SOCIAL


Objektivi i programit

Përmirësimi i mbështetjes sociale të shtresave në nevojë

Realizimi i shpenzimeve : rreth 100% e planifikimit, 252.475 mijë lekë, 29% e buxhetit

TREGUES PERFORMANCE

Perkujdesi Social



- ◆ **TP 1.** Menaxhimi i banesave sociale (në % kundrejt planit)
- ◆ **TP 2.** Shërbime sociale për moshat e treta (në % kundrejt planit)
- ◆ **TP 3.** Shërbime sociale për fëmijët në nevojë (në % kundrejt planit)
- ◆ **TP 4.** Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë (në % kundrejt planit)



PROGRAMI

MENAXHIMI I TRANSPORTIT RRUGOR

Objektivi i programit

Bashkia siguron akses rrugor të të gjitha njësive administrative të saj tek shërbimet bazike

Realizimi i shpenzimeve : 100% e planifikimit, 40.273 mijë lekë dhe përbën 5% të buxhetit

TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP1.** Zgjerimi i rrjetit rrugor:
 - Rrugë rurale
 - Rrugë urbane
- ◆ **TP2.** Eficienca e alokimit të buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore:
 - Rrugë rurale
 - Rrugë urbane

Menaxhimi i Transportit Rrugor

